

DURRËS

POP
2019

PERBALLJA
OFERTAVE
POLITIKE



KONTRATA SOCIALE



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Rr. "Abdyl Frasheri"
Pallati 1/10, shk.1, ap.3 Tirane



gadc@gadc.org.al



+355 4 22 555 14



www.popalbania.info



+355 68 20 59 301



+355 4 22 555 14

PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

PRIORITETET E KOMUNITETIT BASHKIA DURRËS

22.6.2019

Prioritet 1: ●

Funksionimi i mekanizmave që sigurojnë shkëmbimin reciprok të informacionit dhe transparencën e vendimeve që merr Bashkia dhe Këshilli Bashkiak ndaj komunitetit.

Prioritet 2: ●

Specifikimi i një zëri buxhetor për të rinjtë në buxhetin vjetor që harton Bashkia.

Prioritet 3: ●

Ngritja dhe funksionimi i qendrave rinore; një në qytetin e Durrësit dhe një në Katund të Ri, gjithashtu ngritja dhe funksionimi i një biblioteke kryesore për Durrës qendër.

Prioritet 4: ●

Zhvillimi i programeve egzistuese për nxitjen e bizneseve të të rinjve dhe grave dhe informimi i vazhdueshëm i publikut mbi programet që zhvillon dhe zbaton Bashkia për nxitjen e punësimit me fokus të rinjtë; gratë kryefamiljare; pjesëtarë madhorë të familjeve me ndihmë ekonomike.

Prioritet 5: ●

Ngritja dhe zgjerimi i hapësirave të gjelbërta në qytet dhe njësitë administrative; ndërhyrje në kanalet kulluese dhe vaditëse në njësitë administrative Manëz, Katund i Ri, Rrashbull dhe Sukth. Vijimi i investimeve që përmirësojnë infrastrukturën, rrugët dytësore dhe sinjalistikën në Rr. A. Goga; Stacionin e Trenit - Ura e Dajlanit- Shkozet; si edhe në Manëz (*Kamerras, Kucok*); Rrashbull (*ShënVlash*); Katund i Ri dhe Sukth (*rrugët dytësore bujqësore*).

Prioritet 6: ●

Shtimi i koshave për mbledhjen e mbetjeve urbane dhe tërheqja e tyre nga makina e mbledhjes së mbeturinave të paktën një herë në dy ditë në të gjitha lagjet e bashkisë Durrës.

Prioritet 7: ●

Përmirësime në infrastrukturën e shkollave (*sisteme ngrohje; laboratorë të informatikës*) si edhe plotësimi i strukturës me personel për pastrimin dhe ruajtjen e shkollave në njësitë administrative të Bashkisë Durrës.

Prioritet 8: ●

Rikonstrukcioni i kopshteve dhe çerdheve në lagjet periferike të qytetit Durrës, në Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Prioritet 9: ●

Përmirësimi i cilësisë së transportit publik (*përcaktimi dhe publikimi i orareve të transportit publik; korrektesë në oraret e mbërritjes në stacion, përmirësim i kushteve higjieno-sanitare, rritja e shpeshtësisë së autobuzëve dhe e kohëzgjatjes së këtij shërbimi edhe pas orës 17.00*) në njësitë administrative të bashkisë Durrës.

Prioritet 10: ●

Zgjidhja e çështjes së transportit të fëmijëve për në shkolla për shkak të distancës së largët nga vendbanimi në njësitë administrative Rrashbull dhe Sukth

Prioritet 11: ●


Zgjidhja me prioritet e furnizimit me ujë dhe problemeve me kanalizimet për lagjet e qytetit të Durrësit dhe njësitë të tjera administrative

Prioritet 12: ●

Zgjerimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror për individët në nevojë dhe ngritja e shërbimeve të reja sipas nevojave të vlerësuara në lagjet e qytetit Durrës në njësitë administrative Manëz, Sukth, Katund i Ri dhe Rrashbull.

Prioritet 13: ●

Zgjerimi i programeve ndërgjegjësuere dhe informuese për komunitetin në lidhje me: dhunën në familje, shërbimet mbrojtëse, fuqizuese dhe riintegruere për viktimat e dhunës në familje.



Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë
Civile Durrës

Mirjam Reçi

Kandidate për Kryetare Bashkie
Partia Socialiste

Valbona Sako

Kandidate për Kryetare Bashkie
Partia Bindja Demokratike

Valbona Sakollari